

ANEKS 4

Për funksionet e transferuara në njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e vitit 2021, disa bashkive i janë akorduar fondet për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen fondet për shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), për shpenzimet operative dhe për shpenzimet për investime.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

2. Qëndrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën e vitit 2021 të bashkive, Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë dhe Kukës i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore për personelin shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër, “Opera Della Madonnina Della Grappa”, Shkodër, “Besa” Vau i Dejës, “Horizont”, Fier dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për bashkitë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë, dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këto qendra.

3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)

Në transfertën e vitit 2021, të bashkive është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Ministria e Brendshme duhet t’ju dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën e vitit 2021, njësitë e vetëqeverisjes vendore i janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

5. Rrugët rurale

Në transfertën e vitit 2021, njësitë të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rurale.

6. Administrimi i pyjeve

Në transfertën e vitit 2021, njësitë të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

7. Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën e vitit 2021, njësitë të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

8. Klubet sportive shumësportëshe , “Partizani” dhe “Studenti”

Në transfertën e vitit 2021, bashkisë Tiranë i janë akorduar fondet për shpenzime për personelin dhe për shpenzime operative për klubet sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Bashkia Tiranë mund të shtojë fonde nga të ardhurat e veta për të rritur cilësinë e shërbimit në këto klube.

9. Mbrojtja Civile

Në transfertën e vitit 2021, bashkive u është akorduar një fond prej 500 milion lekë si transfertë specifike për mbrojtjen civile. Ky fond është shpërndarë me një formulë e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Pjesën tjetër të fondit bashkitë mund ta sigurojnë nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës ose/dhe pjesë nga buxhetet e tyre (transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore).

Fondi prej 500 milion lekë si transfertë specifike do të përdoret vetëm për rastet e emergjencave civile dhe është i trashëgueshëm në vitin tjetër me këtë destinacion. Mënyra dhe kriteret e përdorimit të kësaj transferte specifike për mbrojtjen civile propozohen nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave brënda tremujorit të parë të vitit 2021.

Ministria e Mbrojtjes, duhet t'ju dërgojë bashkive kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me mbrojtjen civile. Standardet dhe kriteret e ofrimit të këtij shërbimi do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.